

GJUHA: TRASH ËGIMI KULTURORE JOMATERIALE PËR T'U MBROJTUR. REFLEKTIME DHE PROBLEMATIKA

Prof. Asoc. Dr ELIANA LAÇEJ

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti "Luigj Gurakuqi"
eliana.lacej@unishk.edu.al

Dr. LINDITA KAZAZI

Fakulteti i Gjuhëve të Huaja
Universiteti "Luigj Gurakuqi"

ABSTRACT

The concept of heritage wealth is not limited to its tangible manifestations, such as sites, monuments and archaeological objects that have been preserved over time but embraces traditions and all that is already defined as intangible cultural heritage: what communities receive from their ancestors. them and in turn pass them on to new generations, Intangible cultural heritage exhibits a characteristic dynamic evolution, marked by tradition and innovation. This living, so-called intangible heritage gives each of us a sense of identity and continuity as we constantly appropriate and recreate it. The driving force of cultural diversity, this living heritage is fragile. In recent years, it has gained real worldwide recognition and its preservation has become one of the priorities of international cooperation. In this statement, attention will be paid to language as part of the intangible cultural heritage, as a heritage transmitted by our ancestors, Language is the past, present and future at the same time, which makes the relationship with it quite complex. During the presentation of the phenomenon of the protection of this intangible cultural heritage, some manifestations of its current state, of what the Albanian language is suffering, will be analyzed; the language policies that have been followed will be considered and what needs to be done to preserve it as clean and identity as possible. A possible answer will be found in this paper to the question of what the role of dialect re-evaluations against the risk of the impoverishment of would be Albanian in terms of the native lexicon and the cross-legged reduction of the English language.

Keywords: heritage, language, identity, protection, enrichment.

“Gjuha amtare është si qumështi i nënës... nuk e flet, ajo rrjedh.”

Aharon Appelfeld

Trashëgimia kulturore jomateriale, siç përcaktohet nga Konventa e UNESCO-s, shfaq një evoluim dinamik karakteristik, të shënuar nga tradita dhe inovacioni. Kështu, komunitetet përgjegjëse për ruajtjen e këtij ekuilibri të brishtë trashëgojnë njohuritë e paraardhësve të tyre, të cilat ua përcjellin brezave të rinj përmes një procesi të gjallë dhe në zhvillim. Trashëgimia kulturore, e kuptuar si një sistem i hapur që përfshin forma të shumta – materiale dhe jomateriale, të luajtshme dhe të paluajtshme, digjitale dhe të digjitalizuara, mund të konsiderohet si një element transversal, dhe shfaqet si një faktor kyç në promovimin e diversitetit kulturor dhe në ruajtjen e rrënjëve të identitetit të komuniteteve, duke rritur diversitetin e tyre si pasuri, si dhe në promovimin e dialogut ndërkulturor dhe në zbutjen e tensioneve të natyrës etnike, fetare dhe sociale. Jemi mësuar përgjithësisht të dëgjojmë të flitet, por dhe të flasim, për trashëgiminë kulturore materiale, duke mënjanuar shpeshherë në mënyrë të pavetëdijshme atë jomateriale, saqë nëse do të bënim një sondazh të rastësishëm duke shtruar pyetjen se çfarë është trashëgimia kulturore jomateriale, do të merrnim një rezultat jo të kënaqshëm për dijen rreth saj.

Shkurtimisht, e ndjejmë se duhet bërë një parashkrim rreth dukurisë mbi të cilën mbështetet kjo kumtesë.

Hulumtimi i gjerë i kryer nga Unesco mbi funksionet dhe vlerat e shprehjeve dhe praktikave kulturore, si dhe monumenteve dhe siteve, ka hapur rrugën për qasje të reja për të kuptuar, mbrojtur dhe respektuar trashëgiminë, kulturën e njerëzimit.

Kjo trashëgimi e gjallë, e ashtuquajtur e paprekshme, i jep secilit prej atyre që janë kujdestarët e saj një ndjenjë identiteti dhe vazhdimësie, pasi ata vazhdimisht e përvetësojnë dhe e rikrijojnë atë. Forca lëvizëse e diversitetit kulturor, kjo trashëgimi e gjallë është e brishtë, vitet e fundit ka fituar një njohje të mirëfilltë mbarëbotërore dhe ruajtja e saj është bërë një nga prioritetet e bashkëpunimit ndërkombëtar falë rolit udhëheqës që luajti UNESCO me miratimin, në vitin 2003, të Konventës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale.

Sipas kësaj konvente, trashëgimia kulturore jomateriale – ose e thënë ndryshe trashëgimia e gjallë – është kripa e diversitetit kulturor dhe ruajtja e saj garancia e krijimtarisë së përhershme të njeriut. Konventa e vitit 2003 e përkufizon trashëgiminë kulturore jomateriale, në terma më abstrakte, si praktikat, përfaqësimet, shprehjet, si dhe njohuritë dhe aftësitë që komunitetet, grupet dhe, kur është e zbatueshme, individët i njohin si pjesë të trashëgimisë së tyre kulturore. “TRASHËGIMIA KULTURORE jomateriale nënkupton praktikat, përfaqësimet, shprehjet, njohuritë dhe dijet - si dhe mjetet, objektet, artefaktet dhe hapësirat kulturore të lidhura me to - që komunitetet, grupet dhe në disa raste individët i njohin si pjesë të trashëgimisë së tyre kulturore.

Kjo trashëgimi kulturore jomateriale, e transmetuar brez pas brezi, rikrijohet vazhdimisht nga komuniteti dhe grupet e interesuara në përputhje me mjedisin e tyre, ndërveprimin e tyre me natyrën dhe historinë e tyre, dhe u siguron atyre një ndjenjë identiteti dhe vazhdimësie, duke nxitur kështu respektin për diversitetin kulturor dhe krijimtarinë njerëzore” (Konventa e UNESCO-s për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore jomateriale, 2003). Nëse do të analizonim përkufizimin do të dilnim në përfundimin se ai tregon gjithashtu që trashëgimia kulturore jomateriale që do të mbrohet nga Konventa:

- Transmetohet nga brezi në brez.
- Rikrijohet vazhdimisht nga komunitetet dhe grupet, bazuar në ndërveprimin me natyrën dhe historinë e tyre.
- I ofron komuniteteve dhe grupeve një ndjenjë identiteti dhe vazhdimësie
- Kontribuon në promovimin e respektit për diversitetin kulturor dhe krijimtarinë njerëzore.
- Përputhet me instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.
- Është në përputhje me kërkesat e respektit të ndërsjellë ndërmjet komuniteteve dhe zhvillimit të qëndrueshëm

Siç u përmend më sipër, trashëgimia kulturore jomateriale është edhe tradicionale, edhe e gjallë. Ajo rikrijohet vazhdimisht dhe transmetohet gojariht në shumicën e rasteve. Është e vështirë të flitet për autenticitet në kontekstin e trashëgimisë kulturore jomateriale, saqë disa specialistë këshillojnë të mos përdoret ky term në lidhje me

trashëgiminë e gjallë. Depoja e kësaj trashëgimie është shpirti njerëzor, trupi i njeriut është instrumenti kryesor i përfaqësimit të tij ose – fjalë për fjalë – i mishërimit të tij. Njohuritë dhe aftësitë shpesh ndahen nga një komunitet dhe manifestimet e trashëgimisë kulturore jomateriale janë shpesh ngjarje kolektive.

1. Gjuha si pasuri jomateriale

Koncepti i pasurisë së trashëgimisë nuk kufizohet vetëm në manifestimet e saj të prekshme, si vendet, monumentet dhe objektet arkeologjike që janë ruajtur me kalimin e kohës. Ai gjithashtu përqafon traditat dhe gjithçka që komunitetet marrin nga paraardhësit e tyre dhe nga ana tjetër ua kalojnë brezave të rinj. Gjuha, faktikisht, vendoset në një terren tjetër, sepse është diçka tjetër. Edhe dallimi i mundshëm midis trashëgimisë kulturore (cultural heritage) dhe trashëgimisë, të cilat duken sikur nuk i mbivendosen njëra tjetrës nga ana konceptuale, na shtyn ta shohim gjuhën ndryshe: ajo mund të kuptohet si një trashëgimi e transmetuar nga paraardhësit tanë.

Ideja e trashëgimisë mund të përfshijë gjithashtu aftësinë e një gjuhe për t’u përshtatur me kohën, për të integruar risitë, për të mirëpritur dhe përshtatur elementë me origjinë të huaj, duke reaguar ndaj tyre. Mbrojtja, në këtë rast, mund të hyjë në lojë nëse dikush përpiqet qëllimisht ta përjashtojë ose ta marginalizojë atë, jo sepse dëshiron ta modifikojë.

Gjuha është e kaluara, e tashmja dhe e ardhmja në të njëjtën kohë. Kjo e bën komplekse marrëdhënien me të. Në jomaterialitetin e saj më të pastër, gjuha funksionon si një sistem gramatikor e sintaksor dhe si një sistem i prodhimit leksikor, i pranimit ose i refuzimit të neologjizmave. Pra, funksionon si një makinë: është një mekanizëm në aktivitet të përhershëm, dhe për këtë arsye mbrojtja e këtij mekanizmi është shumë e ndryshme nga çdo gjë tjetër. Tradita u jep njerëzve të sotëm elemente, përdorime dhe aftësi të së shkuarës; gjuha vjen nga larg dhe sjell me vete të kaluarën e saj, por ndërkohë udhëton drejt së ardhmes.

Tullio De Mauro shkruan:

“Gjuha amtare në të cilën kemi lindur dhe kemi mësuar të orientohejmë në botë nuk është një dorashkë, një mjet njëpërdorimsh. Ajo gjallëron jetën tonë psikologjike, kujtimet tona, përjasjet, modelet mendore. Ajo hap rrugët e të kuptuarit me të tjerët që e flasin dhe për këtë arsye është fija lidhëse e jetës dhe e marrëdhënieve tona shoqërore, pëlhura e padukshme dhe e fortë e identitetit grupor”¹.

Gjuha është fakt i shoqërisë, i komuniteteve. Është sistem dinamik marrëdhëniesh mendore e shoqërore, shprehje e kontributit të brezave që në të kaluarën kanë formësuar përdorimin e saj. Gjuha është një laborator i madh krijimtarie dhe shpesh herë shënuesi kryesor i identiteteve kolektive moderne: ajo është shenja që na dallon si shqiptarë, italianë, francezë, arabë etj.

1.1 Gjuha dhe dialekti

Për shkak të vlerës së tyre të madhe shoqërore dhe kulturore, është mirë që gjuhët të konsiderohen mbi të gjitha si fakte kolektive shoqërore dhe kulturore. Nga ky këndvështrim fillojmë të tregojmë rëndësinë e mbajtjes gjallë të gjuhëve të cilat nga pikëpamja sociolinguistike quhen “dialekte”, por që njihen edhe si “paraardhës”, si “gjuhët”, “gjuhët rajonale” ose më thjesht “gjuhët amtare”.

Nëse në shtete të tjera të botës gjuha dhe dialektet kanë marrë shumë vëmendje, në vendin tonë, fatkeqësisht, gjuha e folur dhe dialektet e saj prej vitesh janë lënë në një qoshe të kujtesës së studiuesve dhe akademikëve. Po të viheshim në përballje me akademikët apo studiuesit e fqinjës sonë përtej detit, Italisë, nuk do të hezitoni të pohoni hendequn e madh të krijuar pas viteve 90-të në fushën e studimeve dhe botimeve të qenësishme mbi dialektet e shqipes, variantet dhe nënvariantet e tyre duke ndikuar negativisht në ruajtjen dhe pasurimin e gjuhës shqipe të standardizuar.

Nga pikëpamja diamezike, dialekti konsiderohet sidomos në varietetin e folur, ndërsa të ndryshme mund të jenë rezultatet kur merret në shqyrtim se sa dhe si përdoret dialekti në gjuhën e shkruar, për shembull në letërsi. Mund të ketë shumë arsye që e bëjnë një

¹ <https://icsrcentroponenteblogblog.wordpress.com/2018/02/17/giornata-internazionale-della-lingua-madre/>

autor të zgjedhë dialektin si mjet shprehës. Shpesh ai preferohet sepse konsiderohet më prerës, më i përshtatshëm për të shprehur një ndjenjë.

Mund të jetë një zgjedhje artistike, pra, por edhe ideologjike: përdorimi i dialektit mund të përbëjë vullnetin për ta kundërshtuar atë traditë të ndryshme gjuhësore, e konsideruar e pamjaftueshme për një paraqitje të gjallë të realitetit. Dialekti mund të jetë edhe pika e mbërritjes së një kërkimi drejt rrënjëve, drejt një identiteti të largët a të humbur²

Një hendek të veçantë ka përbërë me vite të tëra mungesa e studimit të gjuhës dhe kulturës arbëreshe. Letërsia arbëreshe ka qenë dhe vazhdon të jetë (edhe pse kohët e fundit vërehen disa lëvizje të vogla në këtë drejtim) pak e njohur në Shqipëri, nëse mendojmë se ajo lexohet vetëm “e përkthyer” në gjuhën standarde.

Gj. Shkurtaç në një analizë të tij mbi gjendjen aktuale të gjuhës shqipe, ndalet në rëndësinë e saj si gjuhë komunikimi, si tregues e simbol etnik, shpirtëror e kulturor, si hallkë e fortë shqiptarie:

Gjuha shqipe, ashtu si të gjitha gjuhët e botës së qytetëruar, duhet parë si minierë e pashtershme, në të cilën duhet të kërkojë çdo shkrimtar e poet dhe të sjellë në faqet e librave të tij hijeshinë burimore dhe “rrgjantet” e pëlqyeshme prej krahinave, ashtu si kanë bërë, në fakt, krijuesit më të mirë. Shumëkush, ndonjëherë edhe pa pasë lexuar ndonjë varg të Fishtës, qahet se nuk e kuptojnë atë dhe se pengesa na qenka gjuha e tij.

Pengesa është mungesa e vullnetit dhe e punës për ta nxënë gjuhën, për t’i qëmtuar e pranuar të gjitha prurjet leksikore e frazeologjike të të gjitha krahinave e nga letërsia e shkruar e traditës dhe e sotmja.

1.2 Dukuria e anglicizmit

Gjuha shqipe, gjatë historisë së saj ka huazuar e vazhdon të huazojë shumë fjalë nga gjuhë të tjera. Ky fenomen po ndodh edhe sot. Në jetën e saj po hyjnë ide, koncepte, dukuri e terma nga gjuhë e kultura të ndryshme sidomos nga ato me ndikim të madh në proceset

² Gramelli F. IL DIALETTO DEL NUOVO MILLENIO Usi, parlanti, apprendenti në <https://www.academia.edu/>

globalizuese. Në këto vitet e fundit, shqipja standarde po përballet me numrin e madh të anglicizmave që po hyjnë si në gjuhën e shkruar ashtu edhe në ligjërimin bisedor.

Romancieri dhe poeti rumun Mihai Mircea Butcovan, duke trajtuar dukurinë e pranisë gjithnjë e në rritje të fjalëve angleze në gjuhët e tjera shtron pyetjen nëse jemi vërtet të bindur se “ushtria e fjalëve angleze është çliruese”, por njëkohësisht e pranon se anglishtja është e dobishme, por nxit që ta përdorim mirë dhe përfundon duke pyetur veten nëse shkrimtari dhe gazetari i njohur italian Cesare Marchi kishte të drejtë kur, në lidhje me folësin dhe shkruesin italian thoshte: “ne jemi disa miliarderë që kërkojnë lëmoshë jashtë vendit”.

Beteja kundër anglicizmave, shkruan gjuhëtarja italiane Roberta D'Alessandro, është e humbur që në fillim sepse gjuha nuk mund të drejtohet apo të detyrohet. Do të thotë që për fjalët e reja angleze kemi nevojë. Në fund të fundit, e thotë edhe Makiaveli: bashkë me një dukuri të re importohet edhe termi që e përcakton.

Giovanni Iamartino, profesor i historisë së gjuhës në Universitetin e Milanos, na kthen në kujtesë faktin që nuk ka gjuhë që të mos jenë të përziera dhe se purizmi gjuhësor është jopraktik, por shton se i takon të gjithë folësve të kenë një qëndrim kritik, jo të paramenduar, por të kujdesshëm. “Huamarrja leksikore është një dhuratë, shprehet ai, por falimentimi gjuhësor është një rrezik që duhet shmangur”.

Atëherë, natyrshëm lind pyetja se cila është gjendja e gjuhës shqipe në këtë këndvështrim, sa është e pushtuar ajo nga dukuria e anglicizmave, a po teprohet në përdorimin e tyre, apo jo. A jemi të gatshëm si studiues që t'i japim përgjigje këtyre pyetjeve? Ndoshta po, ndoshta jo, por me zemër shpresoj dhe uroj që të mos vijë momenti kur në një kumtim timin ta gjej veten në pozicionin e ekspertës së komunikimit, Annamaria Testa, e cila në një artikull të botuar në gazetën “Internazionale” shkruan: “Më ndodh të frekuentoj si mjedise ku fjalët e huaja janë realisht të rralla, ashtu dhe mjedise ku qarkullojnë mesazhe që lidhje me italishten kanë vetëm lidhëzat: Signora! Partecipi al meeting sulle best practices del digital endorsement e del celebrity marketing! Light lunch, RSVP.”³

Futja e fjalëve të huaja në gjuhën shqipe ose përkthimi i duhur e

³ <https://www.internazionale.it/opinione/annamaria-testa/2016/04/11/italiano-anglicismi-treccani>

pasuron atë, por në rastet kur hasemi me një term të përkthyesëm është ekzibicionizëm i pastër të përdorësh fjalën e huaj. Tani çdo individ po pëson shumë ndryshime gjatë jetës së tij. Përsheptimi i proceseve që mbështjellin aspektet e jetës, kërkon gjithashtu në fushën e shprehjes gjuhësore, që individit të vëzhgojë, të reflektojë, të zgjedhë fjalët e duhura, duke mos u mbështetur në fjalën e fundit të futur në përdorim, duke ndjekur modën e momentit, për të shmangur varfërimin në mënyrë të pakthyeshme të trashëgimisë së tij gjuhësore. Shqiptarët po bëhen gjithnjë e më shumë përdorues të fjalorit anglez.

Si ritmi ashtu edhe sasia e përdorimit po arrin nivele aq të larta sa që anglicizmat shumë shpesh zënë vendin e fjalëve shqip. Prandaj duhet të jemi të kujdesshëm dhe të dimë se deri në ç’pikë duhet respektuar “evolucioni natyral” i gjuhës duke e respektuar atë, por duke gjetur gjithashtu edhe se ku mund të ndërhyhet për të ndalur prirjet spontane.⁴

Problemi është, siç mund të shihet, shumë interesant dhe shumë kompleks. Sigurisht që mund të diskutojmë për një kohë të gjatë dhe gjithmonë do të ketë arsye pro dhe kundër. Prandaj besoj se duhet gjetur një mënyrë për ta monitoruar në kohë dhe gjerësisht këtë dukuri me kontributin e të gjithëve.

2. Përfundime

Gjuha është pasuria kryesore që duhet ruajtur, baza dhe përbërësi i trashëgimisë kulturore, mjeti thelbësor i shprehjes së shoqërisë sonë si dhe një instrument i hapjes ndaj botës dhe lëvizjes së lirë. Gjuha e emocioneve tona është pasuria jonë më e çmuar dhe megjithëse problemi gjuhësor vazhdon, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në pjesë të tjera të botës, dhe polemikat dhe paragjykimet për gjuhët e vogla, të lidhura me një realitet emocional, janë ende të dukshme, e përfundoj këtë kumtesë me frazën e famshme të të madhit Nelson Mandela:

“Të flasësh me dikë në një gjuhë që ai kupton, të lejon të arrish trurin e tij. Të flasësh me të në gjuhën e tij amtare do të thotë të arrish zemrën e tij.”

⁴ Grochowska A., La pastasciutta non e’ piu’ trendy? Anglicismi di lusso nell’italiano contemporaneo, Buletini i Universitetit Mariae Curie-Sklodovska – Lublin-Poloni, vol XXVIII, z.2, 2010, fq. 43-59

BIBLIOGRAFIA

- Bettoni C. (2006), *Usare un'altra lingua. Guida alla pragmatica interculturale*, Laterza, Roma-Bari.
- Cabiddu M.A. (acuradi) (2017), *L'italiano alla prova dell'internazionalizzazione*, Guerini e associati
- Grochowska A. (2010), *La pastasciutta none' piu' trendy? Anglicismi di lusso nell'italiano contemporaneo, në « Buletini I Universitetit Mariae Curie-Sklodovska – Lublin-Poloni », vol XXVIII, z.2, fq. 43-59.*
- Maraschio N., D. De Martino (a cura di) (2012), *Fuori l'italiano dall'università?* Laterza, Bari.
- Marazzini C. (2018), *L'italiano è meraviglioso. Come e perché dobbiamo salvare la nostra lingua*, Rizzoli, Milano, pp. 56-69.
- Marazzini C. (2018) *La lingua, il giudice, la costituzione. Una vertenza tutta italiana, e un confronto internazionale*, Pacini, Pisa.
- Marazzini C. (2020) *Lingue: beni collettivi immateriali, che spesso, e per fortuna, si materializzano, në*
<https://accademiadellacrusca.it/it/contenuti/lingue-beni-collettivi-immateriali-che-spesso-e-per-fortuna-si-materializzano/7963>
- Shkurtaj Gj. (2013), *Sociolinguistika e shqipes. Nga dialekologjia te etnografia e të folurit*, Morava, Tiranë.
- Shkurtaj Gj. (2022), *Gjuha si mjet komunikimi, por edhe si simbol i përbashkësisë etnike, në Telegraf.com*

Sitografia

- <https://www.internazionale.it/opinione/>
- <https://icsrcentroponenteblogblog.wordpress.com/>
- <http://www.unesco.org/culture/>
- <http://www.icomos.org/charters/>
- <https://accademiadellacrusca.it/>
- <https://www.academia.edu/>